

Fjalimi i Ministrit Hamza ne Konferencën e organizuar nga Banka Qendrore e Kosovës

- I nderuar Guvernator i Republikës së Kosovës, zoti Mehmeti,
 - Të nderuar Guvernator dhe përfaqësues të institucioneve tjera të vendeve pjesëmarrëse në këtë konferencë,
 - Mysafir të respektuar nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare dhe Donatorë,
 - Zonja dhe zotërinj
-
- Më lejoni që në emër të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë së Kosovës, të ju përshëndes dhe të ju falënderoj për pjesëmarrjen e juaj në këtë Konferencë, të organizuar nga Banka Qendrore e Kosovës
 - Gjatë viteve të kaluara, shumë prej nesh që jemi prezent këtu jemi takuar dhe kemi diskutuar në forume të ngjashme për shumë tema me rëndësi për ekonomitë e vendeve tona, dhe konkluzionet që kemi nxjerr nga këto forume, besoj na kanë shërbyer gjithë ne për adresimin e sfidave me të cilat përballemi
 - Dhe besoj, organizimi i këtij forumi ka të njëjtin qëllim – të flasim e të diskutojmë për çështjet që janë me rëndësi për vendet tona, dhe duke u mbështetur në përvojat dhe ekspertizat tona, të punojmë për reforma të mëtutjeshme, në funksion të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme
 - Unë, që në fillim dua të them se koha kur po mbahet kjo konferencë, është mjaft inkurajuese, me vete faktin se prospektet për rritje ekonomike për regjionin dhe Evropën në përgjithësi, duket të jenë mjaft më optimiste se më parë
 - Këtu po i referohem raportit më të fundit të FMN-së ‘Regional Economic Outlook’, ku ndër të tjera, thotë se ‘Rimëkëmbja në Evropë ka fituar në shpejtësi ku rritja reale e GDP-së për 2017 pritet të jetë 2.4%, që është mjaft më e lart se 1.7% në 2016’.
 - Dhe si duket, në kuptimin e trendit, edhe vendi ynë, Kosova duket se do të përmbyll vitin 2017 me një rritje mjaft të lart dhe kjo rritje presim të vazhdoj edhe në vitet në vijim

- Tani, e kam parasysh se në sesionet e kësaj konference do të diskutohet në detale për shumë çështje, por ajo që dua të them është se për shumë vende të Evropës, e në veçanti për vendet e Ballkanit Perëndimor, janë dy çështje që do duhej të përmendim, në kontekstin e rritjes ekonomike:
 - E para, përderisa normat e rritjes ekonomike mund të jenë të mjaftueshme për një numër ekonomish; për vendet tona regjionale përkundër faktit se presim rritje më të lartë se mesatarja evropiane, këto norma nuk janë të mjaftueshme për t'i adresuar sfidat e papunësisë, bilancit negativ tregtar e kështu me radhë
 - Për t'u siguruar se normat relativisht të larta të papunësisë do të ulen në vitet në vijim, ne duhet të sigurojmë një rritje më të madhe, më kualitative dhe më të qëndrueshme
 - Natyrisht se një rritje më e lartë na duhet edhe në kontekstin e një procesi më të shpejtë të konvergencës me shtet e BE-së
 - Dhe gjëja e dytë që desha të përmend ka të bëjë me rreziqet që akoma janë evident dhe nëse nuk kujdesim në kohë, ato mund të na rrezikojnë dhe normat aktuale të rritjes
- Në këtë kontekst, ne duhet të vazhdojmë me reformat më gjithëpërfshirëse strukturore, dhe të jemi konsistent në këtë drejtim, ashtu që ti mundësojmë sektorit privat të rrisë aktivitetin e tij, dhe ti ofrojmë ambient të parashikueshëm për të bërë biznes
- Unë, si Ministër i Financave, në kontekstin e qasjes në financa, desha të vejë theksin në dy çështje:
 - Stabiliteti fiskal si parakusht për një rritje të qëndrueshme, dhe
 - Reformat strukturore, me theks te veçantë në fushën drejtësisë, që sigurojnë parashikueshmëri në implementimin e ligjit
 - Kjo e fundit, në veçanti është e rëndësishme për vendet tona në regjion
- Për sa i përket stabilitetit fiskal, Qeveria e Kosovës si gjatë viteve të kaluara, dhe në vitet në vijim, do vazhdoj me politikat e saja buxhetore të kujdesshme, për tu siguruar se deficitet buxhetor mbetet në nivelet e pranueshme; që përbërja strukturore e buxhetit të jetë adekuate, dhe që niveli i borxhit publik të jetë i menaxhueshëm
- Për sa i përket reformave në strukturore, ne kemi bërë një punë mjaft premtuese, gjë që është reflektuar me raportin më të fundit të Bankës Botërore 'Të Bërit Biznes'

- Sipas këtij Raporti, Kosova rendite në top-dhjetëshin e vendeve më reformatore në botë, dhe ka kërcyer për 20 vende të renditjen botërore, duke arritur kështu në vendin e 40.
- Sa i përket reformave në drejtësi, ne kemi ndërmarrë hapa mjaft konkret në këtë drejtim, dhe duke qenë se kjo fushë është shumë me prioritet për ne, kemi rritur buxhetin në masë të konsiderueshme për implementim të reformave
- Lidhur me qasjen në financa, Qeveria me ndihmën e donatorëve ka themeluar Fondin për Sigurimin e Kredive për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, dhe tani më ky fond është operacional dhe ka ndërtuar një portfolio mjaft inkurajuese
- Gjatë viteve në vijim, ne do rrisim kapitalin e këtij institucioni, ashtu që ti mundësojmë një përkrahje më të madhe për sektorin bankar
- Duke qenë se unë kam lënë Bankën Qendrore vetëm disa javë më parë, dhe falë komunikimit dhe bashkëpunimit të shkëlqyeshëm me Guvernatorin, jam mirë i informuar mbi ecuritë në këtë sektor, dhe jam i bindur se sektori financiar ne Kosove do të vazhdoj të jetë një nga mbështetësit kryesor të rritjes ekonomike
- Për fund, uroj te keni diskutime frytdhënëse, deh shpresoj do keni pak kohe te shëtisni neper Prishtine dhe Kosovë, pe te pare atë çfarë ofron vendi ynë

Ju faleminderit